

Bachelor në **Menaxhim Agrobiznesi** (180 ECTC, 3 vite akademike, me kohë të plotë)

Profili profesional

Programi i studimit Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi synon arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e drejtimit të agrobiznesit duke synuar të pajisë studentët me njohuritë themelore në këte fushë nëpërmjet integritit të mësimimit me kërkimin. Programi synon të zhvillojë aftësite, shprehitë dhe kompetencat e studentëve për tu bërë ekspertë të denjë të fushës së menaxhimit të bizneseve të fushës së Agrobiznesit. Ky është një program unik në treg dhe merr gjithnjë e më shumë rëndësi si rrjedhojë e rëndësisë që agrobiznesi ka marrë në ekonominë shqiptare.

Unikaliteti dhe rëndësia e këtij programi përmbledhen në pikat e mëposhtme:

1. Rëndësia e këtij programi është e madhe për shkak të testimit në treg për një kohë të gjatë, reflektimit në kurrikula të asaj cka ka kërkuar dhe ka nevojë tregu, edhe sepse studentët e këtij programi priten të jenë një burim i rëndësishëm ekspertësh/specialistësh.
2. Rëndësia e këtij programi është gjithashtu ndërkombëtare, sepse përputhet qartë edhe me politikat e komunitetit europian për zhvillimin e komuniteteve dhe zonave rurale.

Miratimi i këtij programi studimi është bërë me VKM Nr.560, datë 12.08.2005.

Modulet kryesore të trajtuara përgjatë studimeve të këtij programi:

Lëndët që bëjnë pjesë në kurrikulën e programit të studimit Bachelor Menaxhim Agrobiznesi përfshijnë lëndët, që japin formimin e përgjithshëm bazë të lëndëve të kurrikulës (si p.sh hyrja në informatikë, mikroekonomi, makroekonomi, statistikë,) dhe gradualisht në vitet pasardhëse thellohen njohurit në fushën e Agrobiznesit me njohuri aplikimi në biznese. Kjo kurrikul garanton gjithashtu zhvillimin e aftësive të veçanta përveç atyre specifike për profilin, duke ofruar module sikurse janë ato në fushën: e teknologjisë së informacionit - Informatika dhe Njohuri për Informacionin; humane e sociale – Sociologji, Bazat e së Drejtës dhe Histori e Mendimit Ekonomik; e komunikimit dhe ndërveprimit – Komunikim Biznesi dhe Gjuhë e Huaj.

Kurrikula e studimeve Bachelor në Menaxhim Agrobiznesi është strukturuar në përputhje me VKM Nr. 41, Dt. 24/01/2018 dhe me konkretisht:

1. Lendet baze - "Pergatitja metodologjike dhe kultura e pergjithshme" konsistojne ne 5 Module-30 kredite.
2. Lende karakterizuese - "Pergatitja per disiplinen shkencore"-19 Module, 97 kredite.
3. Lende nderdisiplinore integruese - 5 Module, 22 kredite.
4. Lende plotesuese - 2 Module dhe Praktika Profesionale, 22 kredite
5. Detyrime permbyllese - "Provim formimi / Teza e Diplomes", 9 kredite.

a. Formim i përgjithshëm (lende baze) – 30 kredite

1. Matematike,
2. Mikroekonomi,
3. Makroekonomi,
4. Statistike,
5. Sociologji,

b. Formim baze karakterizues (lende karakterizuese)- 97 ECTS

1. Matematike Ekonomike
2. Statistike Biznesi
3. Kontabilitet

4. Bazat e Marketingut 6
5. Drejtimi i Fermave
6. Teknologji e PPBB
7. Drejtim Agrobiznesi
8. Marketing Agroushqimor
9. Komunikim Biznesi
10. Financë
11. Drejtim i Burimeve Njerëzore
12. Çmimet & Tregjet e Produkteve Bujqësore
13. Analizë Financiare
14. Administrim Publik
15. Drejtim Financiar 1
16. Bazat e te Drejtes
17. Siperarrje & Drejtim i Biznesit të Vogël
18. Drejtim Turizmi
19. Analiza e Zinxhirit të Vlerës

c. Formim integruar - 22 kredite

1. Prodhim Bimor
2. Prodhim Shtazor
3. Grup lende me zgjedhje
 - a) *Histori e Mendimit Ekonomik / Integrim European*
 - b) *Kontabilitet Drejtimi / Taksim*
 - c) *Menaxhim Karriere / Njohuri mbi informacionin*

d. Formim Plotësues – 22 Kredite

1. Gjuhe e Huaj (Anglisht)
2. Informatike
3. Praktike Profesionale

e. Detyrime Permbyllesë – 9 kredite

1. Provim formimi / Teme Diplome

Mundësitë për punësim

Studentët e diplomuar në nivelin e parë të studimeve në programin **“Drejtim Agrobiznesi”**, kanë kualifikimin e nevojshëm për të punuar në një numër të madh fushash si:

Menaxhimi i ndërmarrjeve që ofrojnë inpute për fermat bujqësore. Ndërmarrjet/bizneset që merren me ofrimin e farërave, plehrave kimike, mekanikës bujqësore. Këto ndërmarrje kërkojnë specialistë që kanë njohuri menaxheriale, të marketingut, financave dhe kontabilitetit por edhe njohuri bazike për sa i përket prodhimit bimor dhe atij shtazor, njohuri të cilat në pretendojmë që të diplomuarit në programin ‘Drejtim Agrobiznesi’ ti zotërojnë dhe aplikojnë.

Menaxhimi i fermave bujqësore dhe blektorale të orientuara nga tregu. Shumë ferma bujqësore të orientuara nga tregu (që shesin mbi 50% të prodhimit të tyre në vlerë) janë të interesuar për specialistë/menaxherë që kanë njohuri në fushat e prodhimit bujqësor dhe blektoral, menaxhimit dhe marketingut të produkteve të tyre. Po ashtu ato janë të interesuara edhe për kompetenca dhe aftësi në financat e fermave dhe kontabilitetin e tyre.

Menaxhimi i ndërmarrjeve të përpunimit të produkteve bujqësore. Shumë kompani të përpunimit të produkteve bujqësore dhe prodhimit të ushqimit kanë një nevojë imediate për specialistë/menaxherë agrobiznesi, të tilla si ato të përpunimit të perimeve, të përpunimit të mishit, të përpunimit të qumështit, të përpunimit të frutave dhe rrushit. Studentët e diplomuar

në këtë program mund të shërbejnë në këto kompani si menaxherë të përgjithshëm, drejtorë marketingu, agjentë shitjesh, specialistë financash si edhe kontabilistë.

Agjensi të ndryshme shtetërore. Studentët e diplomuar në programin ‘Drejtim Agrobiznesi’ janë të aftë dhe dinjitozë (në terma të njohurive që kanë përfituar) për të punuar edhe në institucione shtetërore (p.sh. në Ministrinë relevante që merren me bujqësinë apo me zhvillimin ekonomik në përgjithësi apo agjensi tjera që kanë në fokus zhvillimin rural në përgjithësi dhe zhvillimin e sektorit të Agrobiznesit në veçanti). Institucionet dhe agjensitë publike kanë nevojë për specialistë me njohuri në menaxhimin e agrobiznesit, në marketing apo edhe në financat e ndërmarrjeve të Agrobiznesit. Njohuritë e tjera bazë në fushën e prodhimit bimor, shtazor dhe në hortikulturë plotësojnë figurën e këtij specialisti që ne pretendojmë të përgatitim me këtë drejtim të ri.

Sistemi bankar dhe ai i mikrofinancës. Bazuar në faktin se studentët e diplomuar në drejtimin Agrobiznes marrin njohuri edhe në lidhje me bankat dhe agjensitë e mikrofinancës ata mund ta gjejnë veten shume mirë edhe si të punësuar në këto institucione. Veçanërisht është për tu theksuar mundësia e madhe që kanë këta specialistë për tu punësuar në agjencitë e mikrofinancës që mund të operojnë apo që do të operojnë në Shqipëri në ndihmë të zhvillimit të sektorit bujqësor në përgjithësi dhe sektorit të Agrobiznesit në veçanti. Ata mund të punësohen në këto institucione si analistë kredie apo edhe si menaxherë të niveleve të ndryshme.

Në nivelin e politik-bërjes. Të diplomuarit në këtë program mund të vijojnë karrierën e tyre, edhe duke u angazhuar në nivelin e politikave të zhvillimit bujqësor në Shqipëri. Me njohuritë që fitojnë ata janë kompetentë për të qënë pjesëmarrës aktivë në këtë proces. Kjo do të nënkuptonte anëtarë të grupeve të punës të ministrive relevante për hartimin e politikave bujqësore apo punonjës në departamente të tjera me lidhje direkte apo indirekte me politik-bërjen.

Institucione të tjera publike dhe private. Ka shumë mundësi të zhvillimit të karrierës për studentët e diplomuar në fushën e Agrobiznesit. Studentët mund të punojnë për kompanitë e sigurimeve dhe sidomos për ato që përfshijnë në portofolin e tyre edhe sigurimin në bujqësi. Ata mund ta zhvillojnë karrierën e tyre edhe si sipërmarrës privatë të një agrobiznesi që e gjen veten në një nga tre hallkat e sistemit të Agrobiznesit, mund të vetëpunësohen si konsulentë agrobiznesi dhe asistojnë sipërmarrësit e agrobizneseve me plan biznese, me konsulencë menaxheriale apo edhe të marketingut. Ata mund të punësohen gjithashtu edhe si specialistë për organizma të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, që merren me çështje të zhvillimit rural dhe atij bujqësor dhe në veçanti me çështje të zhvillimit të agrobiznesit.

PROGRAMI MËSIMOR

Viti, Sem	Nr	Modulet	Kredite
Viti I, Semestri I (1)	1	Matemarike	7
	2	Prodhim Bimor	4
	3	Mikroekonomi I	7
	4	Sociologji	4
	5	Gjuhë e huaj I	3
	6	Bazat e të Drejtës	5
Viti I, Semestri II (2)	1	Matematikë Ekonomike	6
	2	Prodhim Shtazor	4
	3	Makroekonomi I	6
	4	Statistikë	6
	5	Gjuhë e Huaj II	3

	6	Komunikim Biznesi	5	
Viti II, Semestri I (3)	1	Statistikë Biznesi	6	
	2	Informatikë	4	
	3	Kontabilitet	6	
	4	Bazat e Marketingut	5	
	5	Drejtim i Fermave	5	
	6	Teknologji e PPBB	4	
Viti II, Semestri II (4)	1	Drejtim Agrobiznesi	5	
	2	Marketing Agroushqimor	5	
	3	Financë	5	
	4	Drejtimi i Burimeve Njerëzore	5	
	5	Çmimet & Tregjet e Produkteve Bujqësore	5	
	Modul me Zgjedhje 1			
	6	<i>Histori e Doktrinave Ekonomike</i>	5	
	<i>Integrim European</i>			
Viti III, Semestri I (5)	1	Analizë Financiare	5	
	2	Administrim Publik	5	
	3	Drejtim Financiar I	5	
	4	Drejtim Turizmi	6	
	Modul me Zgjedhje 2			
	6	<i>Njohuri mbi Informacionin</i>	4	
	<i>Menaxhim Karriere</i>	4		
	1	Sipërmarrja& Drejtimi i Biznesit të Vogël	5	
	2	Analiza e zinxhirit të vlerës	4	
Viti III, Semestri II (6)	Modul me Zgjedhje 3			
	3	<i>Kontabilitet Drejtimi</i>	5	
		<i>Taksim</i>		
	4	Praktikë profesionale	12	
	5	Teza Bachelor	9	
Totali i Krediteve	1+2+3++4+5+6		180	